



GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, gjykatësi i vetëm në gjykim, Boban Aleksiç, pas shqyrtimit të të dhënave që përmban Aktakuza dhe mbrojtjes së të akuzuarit, provave në shkresat e lëndës dhe në prani të prokurorit të shtetit Kujtesa Fazliu sipas aktakuzës KT.II.520/19 më 11.04.2019, me mbajtjen e seancës dëgjimore dhe publike më 24.04.2019, në 11,30 h, në emër të popullit përpilon këtë :

AKT GJYKIM

I pandehuri **Fadil Ramzibajë**, prej babit **Kamil** i lindur më 13.01.1979 në Gjilan, me vendbanim në fsh. **...** martuar, „baba i tre fëmijëve, „i parasimuar, i papunë, i pa dënuar, me gjendje të dobët ekonomike, Nr. i Letër.1232105972, shqiptar, i Rë Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse egziston dyshimi i bazuar se në gjysmën e muajit mars e deri më 29.03.2019, rreth mesditës, në fsh. **...** K. Novobërdë, në shtëpinë familjare, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të pamundësimit të lëvizjes së lirë, ka mbajtur të lidhur vajzën e tij 10 vjeqare A:R:, me një zingjir metalik, të shkurtur me të cilin ia lidh dy këmbët dhe në mënyrë që të sigurohet se e mitura nuk do të lëvizë ia vedosë dy dryrë të mëdhenjë të cilët i mbyllë me qels, duke mos lënë hapsirë të lëvizjes as për nevojat fiziologjike pa përcjelljen e personit të tretë dhe nuk e zgjidh përkundër kërkesave të saja, duke e mbajtur me forcë të mbyllur mbrenda hapsirës së shtëpisë së tij, deri më 29.03.2019, rreth orë 12.00 h, kur për shkak të shqetsimit që e mitura A:R: nuk vijonte mësimin në shkollë, shkon një komision i shkollës dhe e gjejnë të lidhur në shtëpi, me çrast edhe e raportojnë rastin në policë.

- Me çka ka kryer vepër penale : Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 pragrafi 2. Nën paragrafi 2.1, lidhur me paragrafin 1. Të KPRK-së.

Prandaj duke u bazuar në kompetencat e gjykatës e në pajti me nenin 287 KPP-së, dhe në bazë të dispozitave të nenit 4.,17,21,41,42,49,50,51,52,62,73,74,KPRK dhe nenit 365 KPRK,të pandehurit i shqiptohet :

D ë n i m m e k u s h t

I.Me të cilin të pandehurit i caktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë muajve),dhe njëherit ky dënim nuk do të mbahet nëse i pandehuri në një periudhë kohore prej 1.(një)viti prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk dotë kryen këso dhe vepra të ngjajshme,e njëherit i njihet edhe koha e kaluar në paraburgim.

II:Shqiptohet masa plotësuese e dënimit dhe konfiskohet mjetet me të cilat është kryer vepra penale si 1. Zingjir,1.dry, me qels.

E dëmtuara **Arshina Ferri** **për realizimin e të drejtës pasurore udhëzohet në kontest civil tek gjykata kompetente.**

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 20€ në afat prej 15 dite nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë. Nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

Në pajtim me nenin 39 par.3. nënparag.3.1,Ligjit mbi Kompenzimin e viktimave të paguaj taksën në vlerë prej 30 € (tridhjet)€ nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokurorija Themelore në Gjilan ,me Aktakuzën KT-II.520/19 më 11.04.2019,e ngarkon të pandehurin **Arshina Ferri** se ka kryer veper penale **Privim i kundërligjshëm i lirisë** nga neni 196 pragrafi 2. Nën paragrafi 2.1,lidhur me paragrafin 1. Të KPRK-së.,në kohen dhe vendin e cekur si në dispozitivin e kësaj aktakuze.

Gjykata e mbajtur seancën e parë dëgjimore më 24.04.2019 në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit dhe i pandehuri **Arshina Ferri** të cilit i është

lexuar aktakuza ku i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën e cila i vehehet në barrë, duke theksuar se e pranon veprën penale në tërësi si në aktakuzë dhe e pranon se është fajtorë, është pendur dukshëm duke i propozuar gjykatës që ta liroj dhe se një gjë etillë nuk do të paraqitet kurrë më, se është njeri i pashkolluar, dhe mënyrë e veprimit të tij ka ardhë nga mosdija duke mendur se ka gjetë formën për ta edukuar. Prandaj edhe një herë kërkon nga gjykata një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit deklaron se qëllimi i tij ishte që në atë mënyrë ta kufizoj që vajza e tij mos ti bashkangjitet fëmijëve të shfrenuar duke mendur se kjo është forma e edukimit. Gjithashtu gjykata ka shqyrtuar edhe deklaratën me shkrim të drejtorit të shkollës. Në shkresat e lëndës janë lexuar edhe tri deklaratat mjekësore se njeriu në fjalë është i pashkollë dhe i padijshëm dhe veprimet e tij janë bë për të edukuar vajzën. Gjykata pas lezimit dhe shqyrtimit të aktakuzës se pranimi i fajsisë nga ana e të pandehurit në mënyrë vullnetare është një rrethanë lehtësuese, dhe se aktakuza nuk përfshinë asnjë shkelje ligjore sipas nenit 253 KPRK dhe se nuk pati nevoj të shqyrtohen edhe prova të tjera.

Në bazë të asaj që u tha edhe më lartë i pandehuri shallet fajtor për kryerjen e kësaj veprë penale, dhe se e ka pranuar se është fajtor dhe përgjegjës penalisht, dhe se sipas nenit 196 parashihet se çdo veprim i mbylljes, ndalimit të lëvizjes dhe formatjere të ngjajshme për të pamundësu lëvizjen e lirë një personi denohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej tri vjete deri sa në paragraf II. në paragraf 2.1, e nëse vepra penale kryhet ndaj viktimave ushqyese atëherë dënimi me është në kohëzgjatje prej 6-5 vjet.

Lidhur me vendosjen e lartësisë dhe llojit të dënimit të sanksionit penal, gjykata duke u nisur sipas nenit 41 KPRK, sipas së cilit i pandehuri denohet për veprën penale dhe në bazë të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së i caktohet dënimi, duke i marrë arsysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, mandej edhe pranimi i fajsisë që është i pashkolluar, gjendja e tij e dobët materiale dhe duke e marrë parasysht edhe veprimit e marra gjaja se për edukimin e fëmijut të tij dhe ka vepruar duke mendur se po e edukon duke e izoluar nga rrethi dhe fëmijët e padisiplinuar. Rrethana rënduese nuk pati dhe një dënim me kusht jam i bindur se

do të ndikoj dukshëm në sjelljen e tij në të ardhmen dhe një gjë të tillë nuk e përsërit.

Një dënim i tillë gjykata mendon se është i drejtë dhe në përpjestim me kryerjen e veprës penale dhe pasojat që rrjedhin nga kjo.

Në bazë të nenit 463 të LPP e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil dhe se shënimet e kësaj procedure nuk paraqesin bazë të plotë apo të pjesërishtme të përsëritjes së aktgjyqimit.

Gjykata i ka shqiptuar edhe dënimin lotësues, konfiskimin e mjeteve për kryerjen e veprës penale në bazë të nenit 62.parag.2. nënparag.2.7 me qëllim që dënimi plotësues mund të shqiptohet me dënim kryesor apo edhe alternativ.


Verdimitin për paushall gjyqësor gjykata e merr në bazë të nenit 450,451,453 KPRK dhe e obligon të pandehurin që ta paguaj duke e pasur parasysh edhe kushtet pasurore dhe kohën për të cilën duhet ta kryej pagesën.

Gjykata i ka vlerësuar edhe rrethanat e tjera dhe ka gjetur se e tështë shkon në mbështetje të gjendjes faktike dhe vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË NOVOBËRDË

P.nr.23/19 TË 24.04. 2019,

Këshilla Juridike: Ndaj këtij Aktgjykimi pala mund të ushtroj ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 15 dita nga dita e marrjespërmes kësaj gjykate.



Gjyqëtari:

Boban Alerksiç d.v.